


# THIRRJE PËR APLIKIME



**CRLDS**

CENTER FOR REGIONAL AND  
LOCAL DEVELOPMENT STUDIES  
ALBANIA

## INSTITUTI PËR VAJZAT DHE GRATË NË POLITIKAT E SIGURISË KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE

**1- 4 Tetor 2019**

Center for Regional and Local Development Studies (CRLDS), me mbështetjen financiare të Ambasadës së SHBA në Shqipëri, do të organizojë në Tiranë, në datat 1- 4 Tetor 2019, Institutin për Vajzat dhe Gratë në Politikat e Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare.

Instituti ka synim fuqizimin përmes dijes dhe zhvillimin e gjeneratës së ardhshme të vajzave/grave si kontribuese proaktive në politikat e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Instituti për Vajzat dhe Gratë në Politikat e Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare është një program trajnimi 4 ditor, në kuadër të 70 vjetorit të krijimit të NATO-s dhe 10-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO. Ky program është frymëzuar nga Study of the U.S. Institute for Scholars on U.S. National Security Policymaking dhe vjen si një nevojë për të kontribuar përmes njohurive në fuqizimin e vajzave/grave dhe rritjen e angazhimit të tyre për një politikë më të mirë të Sigurisë si dhe ndërgjegjësimin e opinionit publik shqiptar dhe rajonal për rëndësinë e forcimit dhe mbështetjes së NATO-s.

Instituti për Vajzat dhe Gratë në Politikat e Sigurisë Kombëtare dhe Ndërkombëtare, përmes leksioneve nga profesorë të njohur vendas e të huaj si dhe debateve që do të zhvillohen me ekspertë të nivelit të lartë nga Ambasada amerikane, BE, NATO, Ministria e Mbrojtjes etj., do të ofrojë njohuri teorike dhe praktike mbi procesin e politikëbërjes në fushën e Sigurisë dhe aktorët që japin kontribut në formësimin e politikave të sigurisë; natyrën e kërcënimeve ndaj sigurisë, rolin e NATO-s dhe sfidat me të cilat ajo përballet në 70-vjetorin e themelimit.

Pjesëmarrëset do të kenë mundësi të zhvillojnë edhe vizita me karakter informues në fushën e sigurisë në disa institucione në Tiranë.

### **Programi i Institutit përfshin tre module kryesore:**

- 1) Procesi i formësimit të politikës së sigurisë, roli i aktorëve të ndryshëm në hartimin e kësaj politike duke ofruar përvoja të ndryshme (rasti i SHBA-së, BE-së, Shqipërisë).
- 2) Analiza e mjedisit kombëtar, rajonal dhe global të sigurisë, duke u fokusuar kryesisht në fenomenin e migracionit dhe terrorizmit.
- 3) Roli i NATO-s, ndryshimi i konceptit të saj strategjik në 70 vjet që nga themelimi i saj dhe sfidat aktuale.

### **Kriteret e aplikimit**

1. Aplikueset duhet të jenë:
  - a) të diplomuara në Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Rajonale politike
  - b) studente të ciklit të dytë të studimeve (master) në Shkenca Politike, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Studime Rajonale politike ose
  - c) doktorante apo studiuese të reja (doktore shkencash) në fushat e mësipërme apo të ngjashme me to
2. Duhet të zotërojnë gjuhën angleze minimalisht në nivel B2 të vërtetuar me certifikatë. (Aplikantët që kanë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze, në nivelin B2 ose më lart, por për motive të ndryshme nuk kanë një certifikatë të njohjes së saj në momentin e aplikimit, do të kenë mundësi t'i nënshtrohen intervistës për të vlerësuar nëse e kanë të mundur të ndjekin pa vështirësi programin).

### **Dokumentet e kërkuara (të hartuara në gjuhën angleze)**

- Curriculum Vitae
- një letër motivimi
- një ese 750-1000 fjalë, (Times New Roman 12pt. font) mbi aspekte të ndryshme të sigurisë kombëtare, rajonale, globale apo procesit të formësimit të politikës së sigurisë, fenomenet apo rreziqet që i kanosen sigurisë, NATO-n etj).

**Afati i aplikimit**

Dokumentet e aplikimit, të hartuara në gjuhën angleze, duhet të dërgohen **brenda datës 10.09.2019**, përmes postës elektronike, në adresën: **susiweinstitute@gmail.com**

**Procesi i përzgjedhjes:**

Përzgjedhja do të bëhet nga një komision i përbërë nga pjesëtarë të grupit organizator të Center for Regional and Local Development Studies (CRLDS) dhe përfaqësues të Ambasadës Amerikane. Aplikantët e përzgjedhura nga aplikimi elektronik do të njoftohen dhe do të ftohen për intervistë, 7-10 ditë pas dorëzimit të aplikimit.


15 aplikantët e përzgjedhura për të marrë pjesë në program do të njoftohen në datën 25 shtator.

**Shpenzimet:**

Pjesëmarrja në këtë program trajnimi është PA pagesë!

Për 5 pjesëmarrëse nga rrethet organizatorët do të mbulojnë shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes për periudhën e kohëzgjatjes së programit.

**Pjesëmarrëset duhet të frekuentojnë të gjitha seancat e trajnimit, të marrin pjesë aktive, dhe të plotësojnë detyrimet e programit. Në përfundim të programit të trajnimit ato do të marrin një certifikatë për kryerjen me sukses të tij në një ceremoni që do të organizohet në Ambasadën e SHBA-së në Tiranë.**



**U.S. EMBASSY**  
Tirana, Albania

*Me mbështetjen financiare të  
Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun  
të Ambasadës së ShBA në Tiranë*